

Tërheqje nga kontrata në distancë ose kontrata jashtë hapësirave afariste të tregtarit nga ana e konsumatorit.

(Ky formular duhet të plotësohet dhe dërgohet vetëm nëse dëshironi të tërhiqeni nga kontrata)

Zegin Healthy Food tel. 072 310 690, mail: zeginonline@zegin.com.mk

— Me këtë unë/ne njoftoj/njoftojmë tërheqjen time/tonën nga kontrata për shitjen e mallrave/shërbimeve të mëposhtme dhe jam i vetëdijshëm për pasojat që shkaktohen;

— Porositur më _____/pranuar më _____;

— Emri dhe mbiemri, respektivisht emërtimi i konsumatorit/ëve

— Adresa e konsumatorit/ëve

— Nënshkrimi i konsumatorit/ëve (vetëm nëse ky formular plotësohet në letër);

Data _____

Udhëzim
për plotësimin e Formularit për ushtrimin e së drejtës për tërheqje nga kontrata
në distancë ose kontrata jashtë hapësirave afariste të tregtarit nga ana e konsumatorit
i hartuar nga ana tregtarit

Udhëzime për ndërprerjen e njëanshme të kontratës

Konsumatori ka të drejtë në mënyrë të njëanshme ta ndërpresë Kontratën brenda 14 (katërbëdhjetë) ditëve, pa dhënë arsye.

Një parakusht për ndërprerjen e njëanshme të Kontratës është që produkti të mos jetë përdorur dhe t'i kthehet tregtarit në të njëjtën gjendje në të cilën është pranuar nga ana e konsumatorit në paketim origjinal të padëmtuar, me etiketë dhe llogari fiskale përkatëse dhe dokumentacion.

Kontrata mund të ndërpritet në mënyrë të njëanshme, pjesërisht për një produkt individual ose në tërësi, në përputhje me Kushtet e përgjithshme të përdorimit të Faqes www.zegin.com.mk dhe [politikës sonë të ankesave](#)

Për të ushtruar të drejtën tuaj për ndërprerje të njëanshme të kësaj Kontrate, ju duhet të na njoftoni për vendimin tuaj për ndërprerje të njëanshme të Kontratës para skadimit të afatit, me një deklaratë të qartë të dërguar me e-mail, e cila do përmbajë emrin, adresën, numrin e telefonit, faksin ose adresën elektronike, e-mailin tuaj.

Afati për ndërprerjen e njëanshme është 14 ditë nga kur malli që është produkt i kontratës ju dorëzohet juve ose një pale të tretë të caktuar nga ju, i cili nuk është transportuesi.

Në rast se pendoheni dhe ndërprisni këtë Kontratë, ne do t'ua kthejmë paratë që kemi marrë nga ju pa vonesë dhe më së voni brenda 14 ditëve nga dita që kemi pranuar vendimin tuaj për të ndërprerë kontratën në mënyrë të njëanshme.

Kthimi mund të bëhet vetëm pasi malli të na kthehet dhe kontrollohet në gjendjen në të cilën është dërguar, duke pasur parasysh plotësimin e kushteve për të drejtën e ndërprerjes së njëanshme të Kontratës. Ju jeni përgjegjës për çdo zvogëlim të vlerës së mallit që rezulton nga trajtimi i mallit, përveç asaj që ka qenë e nevojshme të përcaktohet natyra, karakteristika dhe funksionaliteti i mallit.

Konsiderohet se e keni përmbushur detyrimin tuaj në kohë nëse na e dërgoni ose dorëzoni mallin neve, d.m.th personit që kemi autorizuar për të pranuar mallin, para skadimit të afatit të mësipërm.

Shpenzimet e drejtpërdrejta të kthimit të mallit duhet ti përballoni vetë.

Kthimi i mjeteve financiare të Ju do të kryhet në të njëjtën mënyrë siç e keni bërë pagesën.

Kthimin e mjeteve financiare mund ta bëjmë vetëm pasi malli të jetë kthyer ose pasi që të na jepni dëshmi që na e keni kthyer mallin.

Nëse produkti rezulton me defekt ose i dëmtuar deri në atë masë që produkti nuk mund të rishitet, kthimi i parave të konsumatorit do të refuzohet dhe shërbimi transportues do t'ia kthejë produktin konsumatorit, kështu që konsumatori do detyrohet të paguaj edhe tarifën shtesë të dërgesës. Afati në të cilin konsumatori jep pëlqimin për marrjen e produktit është 15 ditë nga dita e pranimit të njoftimit, se tërheqja nga kontrata nuk është miratuar. Pas skadimit të periudhës së dhënë, ZEGIN Online nuk mban përgjegjësi për produktin, as që është i detyruar ta ruajë produktin.

Kur konsumatori nuk ka të drejtë të tërhiqet nga kontrata

Sipas rregullave ligjore pozitive në RMV për mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve, nuk keni të drejtë të pendoheni dhe të tërhiqeni nga blerja në situatat e mëposhtme:

- kontratat për shërbime kur shërbimi është kryer plotësisht, por nëse nga kontrata për konsumatorin rrjedh detyrimi për pagesë, vetëm nëse ushtrimi ka filluar me pëlqimin paraprak të qartë të konsumatorit dhe me pranimin e tij të qartë që e ai humb të drejtën për t'u tërhequr nga kontrata, pasi kontrata të jetë realizuar plotësisht nga ana e tregtarit;
- kontratat për furnizimin e mallrave ose shërbimeve, çmimi i të cilave varet nga luhatjet e tregjeve financiare mbi të cilat tregtari nuk ka ndikim dhe që mund të lindin gjatë kohës së afatit të tërheqjes nga kontrata;
- kontratat për furnizimin e mallrave sipas specifikimeve të konsumatorit ose të mallrave që padyshim janë të përshtatura për konsumatorin (produkte posaçërisht të dizajnuara për konsumatorin si shembull janë kremrat ose kozmetika e prodhuar në përputhje me kërkesën e konsumatorit);
- kontratat për furnizim të mallrave që prishen lehtë ose të mallrave me afat të shkurtër të përdormit (p.sh. ushqime dhe pije mallra që prishen lehtë ose mallra që kanë afat të shkurtër të përdormit, produkte me kushte të veçanta për ruajtje në temperatura të caktuara);
- kontratat për furnizimin e mallrave të mbyllura origjinale që nuk janë të përshtatshme për kthim për arsye higjienike ose mbrojtje shëndetësore dhe hapen pas dorëzimit (për shembull, dorëzimi i kozmetikës, parfumeve, aksesoreve të ushqimit, biberonëve për shishe, biberonëve qetësues, furçave të dhëmbëve dhe produkte të ngjashme);
- kontratat për furnizimin e mallrave të cilat për nga natyra e tyre pas dorëzimit janë të pandashme dhe përzihen me artikuj të tjerë;

Kërkesa juaj për tërheqje nga kontrata në distancë ose kontrata jashtë hapësirave afariste të tregtarit mund të dërgohet në mënyrë elektronike në e-mail: zeginonline@zegin.com.mk, ose në telefon 072

310 690 me deklaratë ku do shprehni Vullnetin tuaj për të ndërprerë kontratën për të cilën do të merrni udhëzime të hollësishme për veprimet e mëtejshme.

ZEGIN Online do t'ju dërgojë konfirmim për pranimin e kërkesës suaj për tërheqje nga kontrata.